

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 30.06.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 984, të datës 17.06.2026, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2027 - 2029

1. Për aprovimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2027 – 2029, në Komunën e Fushë-Kosovës, me kufijtë e caktuar buxhetor në shumën e mjeteve financiare si vijon:
 - 1.1 Për vitin 2027 buxheti i komunës është në shumën e mjeteve financiare prej: 29,389,877.00€;
 - 1.2 Për vitin 2028 buxheti i komunës është në shumën e mjeteve financiare prej: 30,933,678.00€ dhe
 - 1.3 Për vitin 2029 buxheti i komunës është në shumën e mjeteve financiare prej: 32,735,875.00€.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi për Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale për vitet 2027 - 2029, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së BF, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË ,KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 992, të datës 19.06.2026, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b, c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 27, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27.2008), nenin 6, nenin 8, paragrafi 1.2, paragrafi 7, të Ligjit 10/L-001 për ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026 (Gazeta zyrtare Nr. 04/2026), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c, ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshim-plotësimin e Vendimit Nr. 145, të datës 04.05.2026 lidhur me ridestinimin e mjeteve financiare për buxhetin e pa shpenzuar të vitit 2025, për shpenzim në vitin 2026


1. Për ndryshim-plotësimin e Vendimit Nr. 145, të datës 04.05.2026, lidhur me ridestinimin e mjeteve financiare për buxhetin e pa shpenzuar të vitit 2025, për shpenzim në vitin 2026 në shumë të përgjithshme prej: 15,000.00€, nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve prej kodeve të nën-programeve si vijon:
 - 1.1 Zyra e Kryetarit të Komunës - kodi i nën-programit Nr. 16002, shuma e mjeteve financiare prej: 9,000.00€ nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve tek kodi i nën-programit Infrastruktura Publike Nr. 18162;
 - 1.2 Integritet Evropean kodi i nën-programit Nr. 16542, shuma e mjeteve financiare prej: 2,000.00€ nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve tek kodi i nën-programit Infrastruktura Publike Nr. 18162 dhe
 - 1.3 Shërbimet Sociale kodi i nën-programit Nr. 75506, shuma e mjeteve financiare prej: 4,000.00€ nga kategoria ekonomike e pagave dhe shtesave, bartet për shpenzim në kategorinë ekonomike të mallrave e shërbimeve tek kodi i nën-programit Infrastruktura Publike Nr. 18162.
2. Mjetet financiare të bartura për shpenzim në vitin 2026 në kategorinë ekonomike mallra e shërbime, të evidentuara në paragrafin një, nën-paragrafët 1.1, 1.2 dhe 1.3, shpenzohen për pagesat e obligimeve financiare - faturave të vitit 2026, sipas kontratave kornizë.

3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Buxhetit e Financave, Drejtorisë së Shërbimeve Publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës dhe është pjesë përbërëse e Vendimit Nr. 145, të datës 04.05.2026, për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar të vitit 2025, për shpenzim në vitin 2026.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së BF, Drejtorisë së SHP, Drejtorateve tjera Komunale dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 743, të datës 15.05.2026, të paraqitur për shqyrtim nga Drejtoria e Planifikimit Urban, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa, bazuar në nenin 5, shkronja (b), nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 14.1, nenin 17, shkronja (c, m), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c, i), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për aprovimin Propozimit Nr. 743, të datës 15.05.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit 'Hospica' në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe

1. Për aprovimin e Propozimit Nr. 743, të datës 15.05.2026, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Spitalit 'Hospica', në Ngastrën Kadastrale Nr. P-72514009-00706-13, në Zonën Kadastrale Sllatinë e Madhe, me sipërfaqe S=50000m², e evidentuar në certifikatën e pronës së datës 30.06.2026, me zotimin e Drejtorisë së Planifikimit Urban për përfshirjen e saj, në dokumentet e planifikimit hapësinorë të Komunës së Fushë-Kosovës.
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, Drejtorisë së Pronës dhe Drejtorisë së Gjeodezisë e Kadastrit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së Pronës, Drejtorisë së GJK, Drejtorisë së SHMS dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', të shqyrtuara në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h, l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (g, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, nenin 4, paragrafi 4, nën paragrafi 4.1, nenin 5, të Rregullores për përmbajtjen e simboleve komunale dhe kushteve për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera Nr. 83, të datës 06.06.2016, mori:

V E N D I M

Për shpalljen e titullit për z. Gani Shaban Bajrami 'Qytetar nderi' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026


1. Për aprovimin e 'Propozimit për shpalljen e titullit 'Qytetar nderi' të Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', për personalitetin e shquar **z. Gani Shaban Bajrami**, i lindur me datën 13.09.1953, me vendbanim në Fushë-Kosovës, me motivacionin për dhënien e kontributit të jashtëzakonshëm jetësor në fushën e informimit dhe gazetarisë, profesionalizimin e treguar si gazetar, komentator dhe redaktor, si dhe për pasqyrimin me dinjitet e përkushtim të ngajrjeve shoqërore në Komunën e Fushë-Kosovës dhe më gjerë.
2. Titulli dhe dekorata përkatëse do t'i dorëzohen personalisht të nderuarit Gani Shaban Bajrami në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Komuna e Fushë-Kosovës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe organizimin e ceremonisë së dorëzimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës së Fushë-Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2026, pas shqyrtimit të 'Propozimit të Kryetarit të Komunës për shpalljen e titullit për nderimin e të ndjerit Fazli Haziri 'Qytetar nderi post mortem' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026', të shqyrtuara në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (h, l) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 27, shkronja (g, nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M


Për shpalljen e titullit për nderimin e të ndjerit Fazli Haziri 'Qytetar nderi post mortem' i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026

1. Për shpalljen e titullit për nderimin e të ndjerit Fazli Haziri i lindur me datën 20.05.1957 'Qytetar nderi post mortem', i Komunës së Fushë-Kosovës për vitin 2026, veprimtarit dhe personalitet të shquar me kontributin e tij, në shërbim të qytetarëve të komunës tonë, në fushën e kulturës, bibliotekave, artit, shumë shfaqjeve në teatrin amator 'Qëndresa' të Fushë-Kosovës.
2. Titulli dhe dekorata përkatëse do t'i dorëzohen familjes së të ndjerit, në një ceremoni zyrtare të organizuar nga Komuna e Fushë-Kosovës.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi dhe organizimin e ceremonisë së dorëzimit, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhën zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS, Familjes dhe Arkivës.

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Propozimit të paraqitur për shqyrtim nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës, për plotësimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra me anëtarin e Partisë Demokratike të Kosovës znj. Aida Alimi, në përbërjen e Komitetit, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (e), nenin 51, paragrafi 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 1 dhe 3, nenin 14, nenin 15, të Udhëzimit Administrativ Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, nenin 27, shkronja (e), nenin 40, paragrafi 40.1, shkronja (ç), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 74, të datës 24.02.2026

1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3, të vendimit Nr. 74, të datës 24.02.2026, për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra me anëtarin e Kuvendit të Komunës znj. Aida Alimi - përfaqësuese e Partisë Demokratike të Kosovës.
2. Ky vendim është pjesë përbërëse e vendimit Nr. 74, të datës 24.02.2026, për themelimin e Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra në Komunën e Fushë-Kosovës dhe parasheh detyrat dhe përgjegjësitë e definuara në nenin 10, të Rregullores Nr. 04, të datës 12.01.2017, për përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve tjera.
3. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Financave e Buxhetit dhe Udhëheqëses së Personelit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës dhe është pjesë përbërëse e vendimit me Nr. 74, të datës 24.02.2026.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,

Drejtorisë së FB, Anëtarëve të Komitetit për Bujqësi dhe Ujëra,
Udhëheqëses së Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Rekomandimit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e datës 29.06.2026, për plotësimin e përbërjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2025-2029, me z. Durim Hajra - Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Fushë-Kosovës, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (l), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7, të Ligjit për Policinë 04/L-076 (Gazeta Zyrtare Nr. 04/2012), nenin 3, nenin 4, nenin 9 dhe nenin 14 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës Nr. 98, të datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për ndryshimin - plotësimin e vendimit Nr. 76, të datës 24.02.2026


1. Për ndryshim - plotësimin e paragrafit 2, në të cilin shtohet nën-paragrafit 2.23, pjesë përbërse e vendimit Nr. 76, të datës 24.02.2026, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi të Komunës së Fushë-Kosovës për mandatin zgjedhor 2025-2029, me anëtarin e ri z. Durim Hajra - Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi është përgjegjës për kryerjen e detyrave dhe punëve të caktuara me Udhëzimin Administrativ Nr. 27/2012 të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Nr. 03/2012 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi dhe për punën e tij e informon Kuvendin e Komunës.
3. Anëtarët e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi kompensohen nga buxheti i komunës në mënyrë ekuivalente me shumën e kompensimit, të anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa, vetëm për gjashtë mbledhje në vitë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Anëtarëve të KKSB, Drejtorisë së BF, Udhëheqëses të Personelit dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË - KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026 dhe vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 586, të datës 31.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 17, paragrafi 1, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, (Gazeta Zyrtare Nr. 27.2008), nenin 36, paragrafi 3, i Rregullës Financiare Nr. 01/2013 - Ministria e Financave - shpenzimi i parave publike, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për aprovimin e Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës

1. Për aprovimin e 'Rregullores për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të ndarjes së subvencioneve nga komuna.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për kushtet kriteret dhe procedurat për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtoritë e Komunës, që bëjnë ndarje të subvencioneve.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës dhe shfuqizon Rregulloren për ndarjen e subvencioneve Nr. 83, të datës 14.06.2013.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorive të Komunës dhe Arkivës**

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjät Hasani



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË -KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026 dhe vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 586, të datës 31.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 15, të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr. 03/L-049, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e 'Rregullores për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit të shfrytëzimit të hapësirave publike.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për shfrytëzimin e përkohshëm të sipërfaqeve të hapësirave publike në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban, Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Drejtorisë së Inspektoratit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së SHP, Drejtorisë së INSPK, Drejtorive tjera të Komunës dhe Arkivës

**Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Vlonjat Hasani**



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE

226
03 07 2026



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË, KOSOVO POLJE



Datë: 02.07.2026

Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.06.2026, pas shqyrtimit të Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane, të hartuar nga Grupi Punues sipas vendimit të Kuvendit të Komunës Nr. 108, të datës 19.03.2026 dhe vendimit të Kryetarit të Komunës Nr. 586, të datës 31.03.2026, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 34, paragrafi 34.4, nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28.2008), nenin 4, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2019, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 14, nenin 15, nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës Nr. 98, ta datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

Për miratimin e Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës

1. Për miratimin e 'Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës'.
2. Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës, e cekur në pikën një të këtij vendimi, parasheh mënyrën e rregullimit dhe organizimit të lagjeve urbane në qytet dhe fshatrave në territorin e komunës.
3. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Rregullorja për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatrat vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave tjera për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës dhe Drejtorisë së Administratës.
5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqën e komunës dhe shfuqizon Rregulloren Nr. 218, të datës 15.10.2008, për organizimin, strukturën dhe funksionimin e Bashkësive Vendore në territorin e Komunës së Fushë-Kosovës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së Administratës, Drejtorive të Komunës dhe Arkivës

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Vlonjat Hasani

